

# ***PËRMBLEDHJE E SAKRAMENTEVE***



# SAKRAMENTET E KISHËS KATOLIKE





## SAKRAMENTI I PAGËZIMIT

- Pagëzimi është Sakramenti i parë i hyrjes në jetën e krishterë.
- Pagëzimi na liron nga mëkati; na bën bir/bij të Zotit, na bën gjymtyrë të Krishtit, na bën pjesë të Kishës dhe të misionit të saj.
- Ne nuk lindim të krishterë, por bëhemi të krishterë vetëm nëpërmjet Pagëzimit.
- Pagëzimi është një vulë shpirtërore, kështu që nuk mund as të përsëritet, as të hiqet kurrë. Merret vetëm një herë në jetë dhe mbetet përgjithmonë.
- Pagëzimi është i nevojshëm për shëlbimin e shpirtit. Kisha njeh vetëm Pagëzimin si *mjet të zakonshëm* për shëlbimin.
- Kisha thotë që edhe ata që nuk janë të pagëzuar, mund të shpëtojnë, pasi Zoti i ka themeluar Sakramentet por nuk është i lidhur me to: ai përdor rrugë të jashtëzakonshme për të shpëtuar shpirtin e njerëzve.
- Duke qenë se Pagëzimi është i nevojshëm për shëlbimin e shpirtit, kushdo mund të pagëzojë, vetëm duhet të ketë qëllimin të bëjë atë që bën Kisha nëpërmjet Pagëzimit. Kjo vlen në ato raste kur njeriu që do të pagëzohet është në gjendje rreziku për jetën dhe kur ministri i zakonshëm i Pagëzimit, pra prifti, nuk gjendet në ato momente.



## SAKRAMENTI I PAGËZIMIT

- Kisha ortodokse dhe ato kisha protestante që besojnë në Trininë e Shenjtë e kanë të vlefshëm Sakramentin e Pagëzimit, kurse Dëshmitarët e Jehovahit jo.
- Pagëzimi i fëmijëve duhet të bëhet sa më shpejt, brenda javëve të para të lindjes.
- Përsa i përket fëmijëve që vdesin pa marrë Pagëzimin, Kisha i vë në duart e Mëshirës Hyjnore dhe ka shpresa të mëdha që Zoti i ofron këtyre fëmijëve rrugë shpëtimi.
- Fëmijët i pagëzojmë të vegjël, sepse dhurata e Pagëzimit është një dhuratë tepër e rëndësishme dhe e shtrenjtë dhe nuk i duhet mohuar fëmijës. Po ashtu, sikurse për gjërat e jetës materiale dhe të edukimit, prindi ka përgjegjësi dhe vendos mbi jetën e fëmijës për të mirën e tij, sidomos në vitet e para të jetës.
- Nuk ka kundërshtim midis pagëzimit të fëmijëve të vegjël dhe pagëzimit të Jezusit i rritur, sepse Jezusi është rrethprerë në të tetën ditë nga lindja e tij (që për hebrejtë ishte sikur Pagëzimi për ne) dhe Pagëzimi që ka bërë Jezusi në Jordan nuk është i njëjti Pagëzim dhe nuk ka të njëjtin kuptim sikurse Pagëzimi që bëjnë fëmijët.

## SAKRAMENTI I PAGËZIMIT

- Për të qenë nun/nuneshë duhet të plotësohen disa kushte, ndër të cilat kryesori është ai që nuni/nuna duhet të jetë katolik dhe të jetojë një jetë të përshtatshme me rolin që ndërmerr, që është ai i të shoqëruarit dhe të ndihmuarit të të pagëzuarit në jetën e krishterë.
- Rituali i Pagëzimit është i përbërë nga disa rite, të cilat kanë të gjitha rëndësinë e domethënien e tyre.
- Riti kryesor i Pagëzimit ka të bëjë me derdhjen tre herë në kokë (ose zhytjen tre herë) të kandidatit në ujin e shuguruar, të shoqëruar nga formula sakramentale: Unë të pagëzoj në emër të Atit e të Birit e të Shpirtit Shenjt.
- Një rit tjetër i rëndësishëm, që vijon pas Ritit kryesor, është vajosja me Krizmën e shenjtë: kështu i pagëzuari bëhet i shuguruar i Shpirtit Shenjt dhe bëhet mbret, prift e profet, që janë thirrja e çdo të krishteri.




## Riti «Effatà»

- Një nga ritet më të bukura të këtij sakramenti: effatà është një fjalë antike, në gjuhën aramaike, që do të thotë "çelu" dhe Jezusi ja ka thënë një shurdhmemeci, duke i prekur veshët e gjuhën për ta shëruar: po ashtu, për këtë arsye, prifti i prek fëmijës veshët e buzët, që të mund të dëgjojë e të shpallë Fjalën e Hyjit.

- Marku 7, 33-35:

*Qi e ndau prej popullit veçmas, ia futi gishtërinjtë e vet në veshë, me pështymë të vet ia preku gjuhën, i drejtoi sytë kah qielli, psherëtiu dhe i tha: "Effatha - që do të thotë: "Çelu!" E menjëherë iu çelën veshët e iu zgjidh pengesa e gjuhës dhe foli rrjedhshëm.*



## SAKRAMENTI I KREZMIMIT



# SAKRAMENTI I KREZMIMIT



- Krezmimi është Sakramenti i Pjekurisë shpirtërore.
- Krezmimi na jep plotësinë e hirit.
- Krezmimi na përgatit për luftën shpirtërore.
- Krezmimi na përforcon.
- Krezmimi na jep armët dhe na trajnon si ushtarë të Krishtit.
- Krezmimi na bën gjymtyrë, anëtarë aktivë të Kishës Katolike dhe na jep forcën për ta ndrequr, ndërtuar e përhapur atë sa më shumë.
- Krezmimi na jep forcën për të shpallur publikisht, me fjalë e me vepra Krishtin, pa frikë, pa turp.
- Efekti kryesor i Krezmimit është derdhja e Shpirtit të Shenjtë në shpirtin e atij që krezmohet.

# SAKRAMENTI I KREZMIMIT



- Efekte të tjera të Krezmimi: na rrit dhe thellon hirin e marrë nëpërmjet Pagëzimit; na rrënjos më thellësisht në birësinë hyjnore; na afron më shumë me Krishtin; na rrit në ne dhuratat e Shpirtit të Shenjt; e bën më perfekte lidhjen tonë me Kishën; na jep forcën për ta përhapur e për ta shpallur Krishtin pa frikë e pa turp.
- Krezmimi nuk mund të përsëritet as të anulohet. Ai merret një herë e përgjithmonë.
- Krezmimi nuk është i domosdoshëm për shëlbimin e shpirtit, por gjithsesi për efektet e tij tejet të rëndësishme, nuk duhet të jemi neglizhent ndaj këtij Sakramenti.
- Sakramenti i Krezmimit është themeluar në ditën e Rrëshajëve, kur u jepet Shpirti i Shenjtë Apostujve dhe dishepujve të tjerë të Jezusit. Themelet biblike i gjejmë në Veprat e Apostujve, 2, 1-4.
- Çdo i pagëzuar mund dhe duhet ta marrë Krezmimin.

# SAKRAMENTI I KREZMIMIT



- Për të marrë Krezmimin duhet të jemi në hir të Zotit, pra të mos jemi në gjendje mëkati të rëndë. Kjo sepse Sakramenti i përforcimit ka rolin që të përforcojë hirin e marrë nëpërmjet Pagëzimit, dhe nëq nuk jemi në hir, kuptohet që nuk mund të përforcojmë atë që nuk kemi.
- Nëq Krezmimi merret në gjendje mëkati të rëndë, objektivist kryhet një sakrilegj. Krezmimi i marrë në këtë gjendje është i vlefshëm, por është i pafrytshëm, pra i paaftë të prodhojë fryte në personin që e merr.
- Nëq individi, pasi krezmohet në gjendje mëkati të rëndë, pendohet për mëkati/et e rënda, rrëfëhet e kthehet sërish në hir të Zotit, hiri i tij “ringjallet”, pra fillon sërish të japë frytet e veta në shpirtin e njeriut.
- Nëq ai që do të krezmohet është në gjendje mëkati të rëndë në kushte të zakonshme duhet të rrëfëhet; por nëq për ndonjë arsye të veçantë ai njeri nuk mund të rrëfëhet përpara Krezmimit, është e mjaftueshme *në këto rrethana të veçanta* pendimi i brendshëm, por që duhet të përmbajë në vetvete qëllimin e vërtetë që të bëjë rrëfimin, edhe pas Krezmimit, sa më parë të jetë e mundur.

# SAKRAMENTI I KREZMIMIT



- Krezmimi mund të bëhet si përpara, si pas Kungimit.
- Mosha për të marrë Krezmimin është “mosha e diskrecionit”, pra mosha në të cilën fëmija ka kapacitetin të dallojë të mirën nga e keqja.
- Ministri i zakonshëm i Krezmimit është Ipeshkvi. Çdo prift i autorizuar nga Ipeshkvi mund të japë Krezmimin. Në gjendje rreziku për jetën, çdo prift mund të japë Krezmimin.
- Kisha Ortodokse e ka të vlefshëm Sakramentin e Krezmimit, kurse Kishat protestante, anglikane dhe dëshmitarët e Jehovahit jo.
- Nuni/nuna i Krezmimit kanë rolin që të shoqërojnë të krezmuarin të jetën e krishterë. Është e këshillueshme por jo e detyrueshme që të jetë i/e njëjti/a i Pagëzimit. Për t’u bërë nun/nuneshë duhet të plotësohen disa kushte, ndër të cilat kryesori është ai që të kenë një jetë të përshtatshme me rolin e ndërmarrë.

# SAKRAMENTI I KREZMIMIT

---

- Krezmimi kryhet gjatë Meshës së shenjtë, gjatë Liturgjisë së Sakramentit të Krezmimit, e cila përbëhet nga këto momente: shpallja e fesë; vënie e duarve dhe lutja; krezmimi dhe rituali i paqes.
- Riti i krezmimit është rituali që identifikon Sakramentin e Krezmimit.
- Krezmim do të thotë lyerja me krizmën e shenjtë, që është vaj i përzier me balsam erëmirë. Ky vaj shugurohet nga Ipeshkvi në meshën e së enjtes së madhe.
- Lyerja e parë me Krizmën e shenjtë bëhet gjatë Pagëzimit, kurse lyerja e dytë me krizmën e shenjtë është pikërisht ky sakrament.
- Ipeshkvi lyen gishtin e madh të dorës së djathtë me Krizmën e shenjtë dhe bën një shenjë kryqi në ballin e krezimandit, duke thënë formulën sakramentale: Merre vulën e Shpirtit të Shenjtë, që të jepet si dhuratë.
- Edhe pse ne e marrim Shpirtin e Shenjtë nëpërmjet Pagëzimit, Krezmimi është i nevojshëm për disa arsye: vetë Jezusi ua ka dhënë Apostujve të tij disa herë Shpirtin e Shenjtë, si edhe për mënyrën se si natyra jonë njerëzore është e ndërtuar (kemi nevojë për një zbrazje të vazhdueshme të Shpirtit të Shenjtë).



## *Krezmimi:*

# *Lyerja me Krizmën e Shenjtë*

- Riti i lyerjes së ballit të atij që krezmohet me krizmën e shenjtë është domethënës, përveçse është gjesti themelor i Krezmimit.
- Termi “krezmim” ka të njëjtë origjinë të termit Krisht, që e kanë prejardhjen nga fjala greke “krizma”, “lyerje”. Sikurse Krishti është i lyeri dhe i shuguruari Meshtar, Profet, Mbret, edhe Krezmimi, për të krishterin, është “lyerje” dhe “shugurim” në jetën e Krishtit.
- Krizma është vaj i përzier me balsam erëmirë. Pra, Shpirti i Shenjtë është një balsam i vërtetë për zemrat tona, një balsam erëmirë, që zbret deri në thellësi të zemrave tona, deri në ato brigje të errëta të shpirtit tonë, duke vënë mbi plagët e shumta të shpirtit tonë balsamin e tij shërues dhe duke na dehur me aromën e tij të këndshme që përhapet me shpejtësi në të gjithë qenien tonë, duke penetruar deri në ato vende që asnjëri tjetër nuk arrin të penetrojë:

*"Sytë e tij si pëllumbeshat bregut të ujërave të përroit, dhëmbët e tij të lara me qumësht kur pushojnë brigjeve të lumit! Mollëzat i ka porsishtretër lulesh me balsam, ku rriten bimë erëkëndshme; buzët e tija janë porsi zambaku, kullojnë mirrën e dorës së parë!" (Kantiku i Kantikëve, 5, 12-13)*



## SAKRAMENTI I KUNGIMIT




.....

# SAKRAMENTI I KUNGIMIT



- Kungimi është Sakramenti qendror dhe më i rëndësishëm i Kishës Katolike, burimi dhe kulmi i jetës së krishterë, prandaj quhet ndryshe i Shenjtërueshmi Sakrament.
- Ky Sakrament njihet me emrat: Eukaristi, Darka e Zotit, thyerja e bukës, asamble eukaristike, memoriali i vdekjes dhe ringjalljes së Jezu Krishtit, Sakrifica e shenjtë, Liturgjia e shenjtë, i Shenjtërueshmi Sakrament, Kungimi dhe Mesha e shenjtë.
- Mesha e Shenjtë është e përbërë nga dy pjesë të rëndësishme që përcaktojnë një akt të vetëm kulturi hyjnor: Liturgjia e Fjalës dhe Liturgjia Eukaristike.
- Liturgjia e Fjalës është e përbërë nga leximet e Shkrimeve të Shenjta, nga homilia e atij që kremton Meshën, shpallja e fesë dhe lutja e besimtarëve.
- Liturgjia Eukaristike është e përbërë nga: oferta e bukës dhe e verës, nga lutja eukaristike I, prefacioni, epiklesi, transsubstanciacioni, anamneza, lutjet e ndërmjetësimit, riti i Kungimit dhe në fund bekimi i Meshtarit me ritin e lëshimit.



Bota mund të qëndrojë pa  
diellin, por jo pa Meshën e  
Shenjtë.

Shën Padre Pio

# SAKRAMENTI I KUNGIMIT



## Gjatë transubstancionit:

- Fjalët e Jezu Krishtit që thuhën nga meshtari gjatë shugurimit të bukës e të verës, që bëhen realisht Korpi e Gjaku i Jezu Krishtit janë:
- *Merrni e hani të gjithë prej këtij: ky është korpi im që do të flijohet për ju.*
- *Merrni e pini të gjithë prej tij: ky është kelku i gjakut tim, i besëlidhjes së re dhe të amshuar që do të derdhet për ju e për të gjithë njerëzit në shpërblim të mëkateve. Bëni këtë në përkujtimin tim.*
- Për efikasitetin e këtyre fjalëve të thëna nga vetë Jezu Krishti, për fuqinë e Shpirtit të Shenjtë, për faktin që prifti vepron *in persona Christi Capitis*, pra në personin e Krishtit Kokë), vetë Korpi dhe Gjaku i Jezu Krishtit bëhen sakramentalisht dhe realisht të pranishëm, nën speciet eukaristike të bukës e së verës dhe bëhet e pranishme sakrificë e tij e shenjtë, e ofruar në kryq një herë e përgjithmonë.
- **Jezu Krishti bëhet prezent REALISHT edhe pse në mënyrë sakramentale**, pra jo të dukshme, jo materiale, por i fshehur pas shenjave të shenjta (të quajtura specie eukaristike) të bukës e të verës.

# SAKRAMENTI I KUNGIMIT



- Po ashtu, **aktualizohet, bëhet REALISHT e pranishme**, në mënyrë krejt të mrekuellueshme e të padukshme për sytë e trupit dhe që mund të besohet vetëm nëpërmjet fesë, **sakrifica e shenjtë që Jezusi ka bërë në kryq për ne.**
- Jezusi nuk vdes prapë, por po e njëjta dhe e vetmja sakrificë që Jezu Krishti ka bërë
- para 2000 vitesh në kryq për ne, në Jeruzalem në Golgota, **e njëjta dhe e vetmja sakrificë, riprezantohet para nesh (që do të thotë bëhet realisht e pranishme)**, sikur të ishim poshtë Kryqit të Jezusit në Golgota para 2000 e ca vitesh.
- Nën speciet e bukës dhe të verës, pra në mënyrë të fshehur prandaj quhet ndryshe edhe sakramentalisht, Jezusi është prezent realisht, me Korpën (Trupin), Gjakun, Shpirtin e Hyjninë e tij. Pra, **është prezent Jezu Krishti i tërë, njeri dhe Zot!**
- Është prezent trupi i ringjallur i tij, trupi i ashtuquajtur i lavdishëm.

# SAKRAMENTI I KUNGIMIT



- Substanca e bukës ndryshon dhe shndërrohet në Trupin e Krishtit, edhe pse nuk e shohim me sytë njerëzore, sepse nuk është prezent materialisht, por kjo nuk do të thotë që nuk është prezent realisht.
- Në të dyja specie eukaristike (buka dhe vera) është realisht prezent Jezu Krishti i gjallë në tërësinë e tij.
- Nqs kemi nje Ostie te shuguruar (pra një bukë që është shndërruar në Korpin e Krishtit gjatë Meshës nga prifti) dhe e ndajmë në shumë fragmente, në secilin fragment është prezent Jezu Krishti i gjallë dhe i tërë.
- Jezu Krishti ka dhënë disa “prova” të prezencës së tij reale në Eukaristi në ato që quhen “mrekulli eukaristike”, që janë të listuara në mostrën e përgatitur nga i lumi Carlo Acutis.
- Sakramenti i Kungimit është themeluar nga Jezu Krishti në darkën e fundit. Themelet biblike i gjejmë në ungjillin sipas Markut 14, 22-24; Mateu 26, 26-28; Luka 22, 19-20; në Letrën e parë drejtuar Korintasve 11, 23-25.

# MREKULLIA EUKARISTIKE E LANCIANOS

Ka ndodhur ne Lançiano te Italisë. Ne vitin 750 në kishën e Shën Françeskut, ndodhi që një ditë, ndërkohë që prifti po jepte Meshën, në momentin kur po thoshte fjalët “Ky është Korpi im...” e “Ky është Gjaku im pra në momentin e transsubstancionit, buka u bë me të vërtetë mish dhe vera u bë me të vërtetë gjak, per habinë e vetë priftit dhe te njerëzve të pranishëm.



Relikuari që mban reliket e Lancianos



Relike:  
Indi I miokardit të zezës



Relike:  
5 koagulë të gjakut

Këto relike ruhen akoma edhe në ditët e sotme: janë një copë e vërtetë mishi, që e studiar më tej në detaj nga shumë studiozë ka dalë se është mish i vërtetë njeriu, i indit të miokardit të zezës, dhe vazhdon të jetë I GJALLË. Për më tepër, gjaku është gjak i vërtetë njeriu, i grumbulluar ne 5 koagulë te ndryshëm. Gjaku është gjak i grupit AB, qe përkon me grupin e gjakut të njeriut të Sindones.

Këto e shumë të dhëna të tjera shkencor i ka nxjerë komiteti shkencor i caktuar nga OBSH, gjatë një pune prej 15 muajsh për më shumë se 500 ekzaminime mjekësore. Rezultati ka qenë: **Shkenca, e vetëdijshme për limitet e saj, ndalet para pamundësisë për të dhënë një shpjegim shkencor mbi fenomenin.**



**Antonio Salzano, nëna e Carlo Acutis gjatë një interviste mbi Carlon:**

- «Carlo thoshte gjithnjë: Ne jemi më me fat se sa ata që kanë jetuar para 2000 vitesh pranë Jezusit, sepse ata për të parë Jezusin duhej të bënin kilometra të tërë sepse ishte e vështirë që ta arrinin, kurse neve na mjafton që të zbrezim në kishën më të afërt poshtë shtëpisë dhe kemi Jeruzalemin poshtë shtëpisë sonë: pra Zotin e pranishëm realisht».

A close-up photograph of a hand holding a golden chalice. The hand is positioned at the top of the frame, with fingers slightly curled. The chalice is ornate, with a wide rim and a decorative body. The background is blurred, showing a white surface and a red object, possibly a book or a cloth.

# SAKRAMENTI I KUNGIMIT


- **Duhet** të shkojmë në Meshë në ditën e dielë dhe në festat e urdhëruara. Vlen sikurse mesha e së dielës edhe mesha e të shtunës mbasdite. Nqs nuk shkojmë në Meshë të dielën dhe në festat e urdhëruara pa patur ndonjë motiv të rëndësishëm dhe që nuk varet nga vullneti ynë, kryejmë mëkat të rëndë.
- Kungimi **mund** të merret vetëm nqs pasi kemi rrëfyer mëkatet e rënda që mbajmë mend dhe që e dimë në ndërgjegje që kemi bërë. **Nuk duhet të merret Kungimi në gjendje mëkati të rëndë!** Nqs marrim Kungimin në këtë gjendje, kryejmë sakrilegj.
- **Nuk duhet** ngrënë të paktën një orë përpara se të merret Kungimi. **Mund** të pihet dhe të merren ilaçe të domosdoshme. Ky rregull nuk është i vlefshëm për ato kategori më të ndjeshme si të sëmurët dhe ato që kujdesen për to dhe të moshuarit.
- Kungimi **duhet** të merret të paktën një herë në vit (për Pashkë). Nqs nuk e bëjmë këtë, kryejmë mëkat të rëndë.
- Kungimi **mund** të merret maksimumi dy herë në ditë.



# SAKRAMENTI I KUNGIMIT

---

- Është shumë e këshillueshme (por jo e detyrueshme, pra nqs nuk e bëjmë nuk kryejmë mëkat) që të përgatitemi shpirtërisht përpara Meshës dhe që të qëndrojmë ca kohë në lutje dhe falenderim pas Meshës e Kungimit.
- Kungimi mund të merret në gojë. Po ashtu, Kisha lejon që Kungimi të merret në dorë. Për ta marrë Kungimin në dorë, duhet të bëjmë kujdës që të mos na mbeten ose të bien fragmente të Korpit të Krishtit.
- I lumi Carlo Acutis thoshte në lidhje me Adhurimin Eukaristik: “Përballë diellit marrim ngjyrë, kurse përballë Eukaristisë bëhemi shenjt!”
- Kungimi: rrit afërsinë e lidhjen tonë me Jezu Krishtin; e ushqen shpirtin, sikurse ushqimi material ushqen trupin, na pastron nga mëkatet jo të rënda dhe na mbron nga rënia në mëkatet e rënda; na bashkon me engjëjt, shenjtërit dhe të vdekurit tanë të dashur; na rrit dashurinë ndaj Zotit, ndaj vetes dhe ndaj tjetrit.
- Kishat ortodokse e kanë të vlefshëm Sakramentin e Kungimit, kurse Kishat protestante dhe anglikane jo.



Eukaristia është  
autostrada ime  
për në Qiell!

I lumi Carlo Acutis

POEZI E ATË JAIME BONET,  
THEMELUESI I  
KOMUNITETIT "VERBUM  
DEI"

këndon misionari Pablo Muñoz

***Eukaristia e Maria***

*Jezusi im i dashur, Nëna ime e shtrenjtë*

*Ju të dy në Ostie dua të puti*

*Ju të dy në një ndjej që komunikoni*

*Esenca e të dyve në një ushqim të vetëm*

*Me dy "hërplotë" është Ostia e bashkuar*

*Dy flakë Dashurie në një zjarr të vetëm*

*Ëmbëlsia e të dyve në një ushqim të vetëm*

*Dashuri e dyfishtë, Dashuri jetësore!*

*Nëna dhe i Biri, Ostie e shuguruar*

*E të dyve, Mishi dhe Gjaku në një efuzion të vetëm*

*Së bashku me mua jemi tre jetë të bashkuara*

*Jeni Ostie e pandashme, Maria e Jezus.*

*Mish e Gjak i të dyve në një efuzion!*

# **VAZHDON PËRMBLEDHJA E SAKRAMENTEVE...**





# SAKRAMENTI I RRËFIMIT



# SAKRAMENTI I RRËFIMIT

- Sakramenti i Rrëfimit quhet ndryshe edhe Sakramenti i kthimit sepse realizon realisht kthimin tek Hyji Atë; i rrëfimit sepse rrëfimi i mëkateve është një element themelor për vlefshmërinë e këtij Sakramenti; i pendesës sepse nëpërmjet tij ne fillojmë një rrugë kthimi dhe pendese; i faljes sepse nëpërmjet faljes sakramentale Zoti na i fal me të vërtetë mëkatet; i pajtimit sepse realizon pajtimin e vërtetë me Zotin, duke na bërë që të rifitojmë miqësinë me Zotin të cilin e kishim humbur për shkak të mëkatit të rëndë.
- Rrëfimi na pajton me Hyjin, nëpërmjet të cilit marrim Hirin Shenjtërues, që na lejon të jetojmë në miqësi me Hyjin në këtë jetë e në tjetrën, ose me fjalë të tjera, të futemi në Parajsë; na lejon të pajtohemi me Kishën, na shlyen, të paktën pjesërisht, dënimin e përkohshëm që në fakt është si pasojë e mëkatit të bërë që rrëfejmë; na jap paqen në zemër, qetësinë e shpirtit e të ndërgjegjës dhe ngushëllimin e madh shpirtëror; na rrit forcën shpirtërore për luftën e jetesës së krishterë.
- Sakramenti i Rrëfimit është themeluar nga vetë Jezu Krishti. Themelet biblike i gjejmë në Gjoni 20, 19-23: “Dhe, si tha këto fjalë, hukati mbi ta dhe tha: “Merrni Shpirtin e Shenjtë! Atyre që jua falni mëkatet, u falen, e atyre që nuk jua falni, nuk u falen.”



# SAKRAMENTI I RRËFIMIT

- Ne i rrëfejme mëkatet tek prifti sepse vetë Jezu Krishti ka dashur dhe ka urdhëruar që të bëhet kështu. Jezusi këtë pushtet (të faljes së mëkateve) jua ka dhënë Apostujve të tij. Kjo do të thotë që falë vazhdimësisë apostulike, edhe Ipeshkvit e Kishës e kanë këtë pushtet.
- Në fakt, nuk janë Priftërinjtë që i falin mëkatet, por është vetëm Zoti që i fal mëkatet nëpërmjet tyre. Prifti është në dijeni të mëkateve gjatë rrëfimit, jo si njeri, por si Zot. Nëse ai në rastet e tjera mund të marrë njohuri si njeri i thjeshtë, këtu merr njohuri duke u identifikuar me Krishtin Zot, pra vepron in PERSONA CHRISTI (në Personin e Krishtit).
- Rrëfimi është bërë përherë, në çdo kohë, edhe në vitet e para të themelimit të Kishës e të përhapjes së krishterëve. Ndër vite ka ndryshuar mënyra e kryerjes së Sakramentit (si psh frekuenca e mundësisë për të marrë këtë Sakrament) por esenca e Sakramentit mbetet e njëjtë. Asnjë nuk mund ta prekë sepse Sakramenti duke qenë i themeluar nga vetë Krishti, i përket së drejtës hyjnore.



# SAKRAMENTI I RRËFIMIT

Pendimi i brendshëm është gjithnjë i nevojshëm e i domosdoshëm në Sakramentin e rrëfimit. Pra, pendimi është një element ad validitatem i Sakramentit të Rrëfimit, që do të thotë që nëqs nuk ekziston pendimi, Rrëfimi nuk është i vlefshëm. Kjo do të thotë që mëkatet nuk na janë falur nga Zoti (edhe pse prifti mund të ketë thënë formulën sakramentale të faljes) dhe gjithashtu është kryer një sakrilegj, që është mëkat i rëndë.

Pendimi duhet të jetë i vërtetë dhe sidomos i sinqertë. Një pendim për të qenë i sinqertë, duhet të përmbajë në vetvete dhimbjen për mëkatin e bërë dhe qëllimin për të mos e kryer më.


Pendimi mund të jetë dy llojesh: perfekt dhe jo perfekt.

Pendimi perfekt: kur pendohemi për mëkatet që kemi bërë pasi e kuptojmë se sa shumë na do Hyji, sa shumë e kemi ofenduar nëpërmjet mëkatit dhe për këtë arsye na vret në ndërgjegje e pendohemi thellësisht. Ky lloj pendimi na rikthen në hir të Zotit edhe pa bërë akoma rrëfimin, por në të njëjtën kohë, duhet të përmbajë në vetveten të paktën qëllimin, që sa më shpejt të jetë e mundur, të rrëfihen mëkati/mëkatet. Themi “të paktën qëllimin”, sepse mund të ketë situata të veçanta të cilat nuk të lejojnë të rrëfihemi, të paktën jo menjëherë.

Pendimi jo perfekt: kur pendohemi për mëkatet e bëra pasi e ndjejmë e kuptojmë më në fund në ndërgjegje se sa dëm ka bërë mëkati i bërë, se sa i shëmtuar ka qenë dhe sa keq i ka sjellë vetes sonë apo të tjerëve dhe sepse kemi frikë të brendshme nga një gjykim i Zotit, ose nga ferri. Edhe pse janë arsye të drejta e të vërteta, por janë jo perfekte dhe sidomos jo aq të rëndësishme siç është arsyeja që shkaktonte pendimin perfekt. Në këtë rast, vetëm pasi të rrëfihemi, mund të rikthehemi në hirin e Zotit.

Ky dallim na bën të kuptojmë se sa i rëndësishëm është rrëfimi për faljen e mëkateve në të dyja rastet dhe na tregon që thelbi i mëkatit dhe thelbi i rrëfimit është që mëkati, para se të na bëjë keq ne ose tjetrit, ofendon mbi të gjitha Zotin, Krijuesin tonë dhe që dashuria për Zotin është objektivi jonë dhe jo frika ndaj gjykimit të Zotit ose ndaj ferrit.

Mund të ketë disa raste, në të cilat njeriu nuk ka mundësi të rrëfihet. Atëhere është mirë të dimë që Zoti e ka themeluar vetë Sakramentin e Rrëfimit, por nuk është i lidhur me të: pra në raste që nuk varen nga vullneti ynë për të mos u rrëfyer, Ai përdor ata rrugë që Kisha i quan «rrugë të jashtëzakonshme» për të rikthyer shpirtin në hirin shenjtëruar.



# SAKRAMENTI I RRËFIMIT

Një tjetër element ad validitatem i Rrëfimit është rrëfimi i mëkateve, pra që t'i thuhet mëkatet priftit.

Mëkatet që janë të detyrueshme të rrëfohen janë mëkatet e rënda, që duhet të rrëfohen:

- Sipas llojit: Psh. nës themi në rrëfim thjesht: kam kryer akte të papastras kemi thënë pak gjë, se ka dallim psh. Midis të kryerit të një marrëdhënie seksuale jashtëmartesore midis heteroseksualëve dhe midis atyre homoseksualë. Ky i fundit është mëkat më i rëndë;
- Sipas numrit: Psh. Një gjë është të na shpëtojë një herë një sharje ndaj Zotit në mes të një situatë që na tërbon e një tjetër është ta kesh marrë si zakon. Janë të dyja mëkate të rënda por ka ndryshim midis tyre.
- Rrethanat e mëkatit shpesh duhen thënë pasi mund të ndryshojnë rëndësinë e mëkatit: psh një gjë është që të themi një sharje ndaj Zotit në vetvete pa e dëgjuar kush, e një gjë është ta themi përpara fëmijës sonë.

Nqs një njeri nuk i rrëfen të gjitha mëkatet e rënda që ka në ndërgjegje, nuk mund të marrë në asnjë mënyrë Kungimin e Shenjtë. Nqs Kungimi i Shenjtë merret në gjendje mëkati të rëndë, bëhet sakrilegj, pra përdhosje e Korpit të Shenjtë të Krishtit, që po ashtu është mëkat i rëndë.


Nqs nuk na kujtohen një ose disa mëkate të rënda

gjatë rrëfimit dhe kështu që nuk i rrëfejme në atë moment, nqs kemi marrë Kungimin, duke qenë se nuk i kemi fshehur me qëllim ndaj priftit, duhet të jemi të qetë se nuk kemi bërë sakrilegj. Po na u kujtuan, herën tjetër që shkojmë e rrëfemi duhet t'i rrëfejme.



# SAKRAMENTI I RRËFIMIT

- Rrëfimi i singertë fal edhe ato mëkate të cilat mund t'i kemi bërë para shumë vitesh e nuk na kujtohen, por që në zemrën tonë sigurisht, po të na kujtoheshin do të pendoheshim për to, nuk do t'i bënim më e do t'i rrëfenim sapo të ishte e mundur.
- Nqs gjatë rrëfimit ne fshehim **VULLNETARISHT** një ose disa mëkate të rënda, pra nuk ja themi priftit, atëhere ato mëkate nuk na janë falur, rrëfimi i bërë nuk është i vlefshëm dhe është kryer një sakrilegj.
- Nqs na qëllon të biem pothuaj përherë në të njëjtin mëkat, që mund të jetë pika jonë e dobët, nuk duhet të kemi turp, të lodhemi apo të shkurajohemi së rrëfyeri të njëjtin mëkat, pasi rrëfimi na jep forcën për ta hequr dhe çrënjosur nga jeta jonë. Përkundrazi, nqs një njeri shkon e rrëfëhet përherë për të njëjtin mëkat por në fakt nuk ka ndërmend të ndryshojë situatën (jo për shkak të dobësisë por për shkak të mospendimit të tij), prifti mund t'ja japë faljen sakramentale, por ai rrëfim është i pavlefshëm dhe mëkatet mbeten të pafalura.
- Nuk është e detyrueshme, por është e këshillueshme që të rrëfëhen edhe mëkatet jo të rënda.



# SAKRAMENTI I RRËFIMIT

- Elementi i tretë themelor për vlefshmërinë e Sakramentit është falja Sakramentale; jepet nga prifti që vepron in Persona Christi.
- Pas rrëfimit të mëkateve në mënyrë të drejtë e të plotë, dhe pas marrjes së faljes sakramentale, prifti na jep pendesën. Pendesa nuk është një element ad validitatem, por ad integritatem, pra që integron Sakramentin e Rrëfimit. Kjo do të thotë që nëq ne rrëfemi por prifti nuk na jep pendesën, rrëfimi ynë është i vlefshëm, por është i gjymtuar, sepse i mungon pjesa integrale, por jo pa rëndësi.
- Pendesa duhet sepse efektet (pasojat) e mëkatit mbi veten tonë, mbi ata që na rrethojnë e mbi mbarë njerëzimin e krijimin janë të mëdha dhe duhen shlyer, edhe pse mëkati i kryer është falur nëpërmjet rrëfimit; pendesa na bashkon me pendesën ekstreme dhe tejet të dhimbshme që ka bërë Jezu Krishti në kryq, pra i bashkohemi atij në këtë vepër shlyese dhe liruese; po ashtu, ngelen disa tendenca të këqija pas mëkatit që kemi bërë, kështu që pendesa na ndihmon për t'i eliminuar e purifikuar.
- Është e detyrueshme të rrëfemi të paktën një herë në vit, sipas rregullit të Kishës, që do të thotë që nëq nuk rrëfemi të paktën një herë në vit, bëjmë mëkat të rëndë.
- Por, të rrëfemi një herë në vit është minimumi që mund të bëjmë për të shpëtuar shpirtin. Nëq duam të ndërmarrim një rrugëtim të vërtetë pastrimi dhe shenjtërimi, rrëfimi duhet të bëhet me rregullsi dhe me një frekuencë të caktuar. Është e këshillueshme të bëhet të paktën një herë në muaj, por akoma më mirë një herë në 15 ditë; perfekt është ta bëjmë një herë në javë.



# SAKRAMENTI I RRËFIMIT

- Cilido të jetë prifti, nqs ne respektojmë kriteret e rrëfimit, rrëfimi është i vlefshëm. Edhe nqs prifti është në gjendje mëkati të rëndë, rrëfimi që bëjmë tek ai është i vlefshëm. Kjo vlen sepse ky Sakrament komunikon efektet e tij ex opere operato, pra pavarësisht nga prifti me të cilin rrëfehemi.
- Është shumë e këshillueshme që të zgjidhet një prift rrëfyer, i cili është gjithnjë i njëjti, sepse rrëfimi kur bëhet mirë e shpesh, shndërrohet edhe në një mundësi shërimi për zemrën dhe plagët e zemrës dhe të lejon të futesh në një rrugë shpirtërore të vërtetë pastrimi e afërsie me Zotin.
- Prifti nuk mund t'i tregojë, askujt, për asnjë motiv, as nëse e kërcënojnë me vdekje, mëkatet që dikush ja ka rrëfyer gjatë rrëfimit, aq më pak të tregojë personin që i ka rrëfyer.
- Sakramenti i rrëfimit është i vlefshëm edhe në Kishat Ortodokse. Përsa i përket fesë protestante e anglikane, ato nuk e kanë Sakramentin e Rrëfimit.
- Nqs kemi shumë kohë pa u rrëfyer, është e këshillueshme që të bëhet Rrëfimi i përgjithshëm (të bëhet një herë në jetë), pra i të gjitha mëkateve që janë bërë ndër vite, që na kujtohen dhe për të cilat jemi penduar.






## SAKRAMENTI I VAJIMIT



# SAKRAMENTI I VAJIMIT

- Vajimi i të sëmurëve (ose Vajimi) ka rolin specifik për të ngushëlluar të sëmurët.
- Kjo praktikë ka të bëjë me lyerjen me vaj të bekuar të të sëmurit.
- Ndër shekuj, Vajimi i është administruar (dhënë) atyre të sëmurëve që ishin në prag të vdekjes, prandaj për këtë arsye njihet edhe me emrin Vajimi Ekstrem.
- Sakramenti i Vajimit është themeluar nga vetë Jezu Krishti. Themelet biblike të këtij Sakramenti i gjejmë në Letrën e Jakobit 5, 14-15.
- Koha më e mirë për ta marrë këtë Sakrament është kur një besimtar, për shkak të një sëmundjeje ose të plakjes, fillon të jetë në rrezik vdekjeje. Po ashtu, është i përshtatëm që të jepet përpara një operacioni të vështirë kirurgjik me rrezik për jetën
- Vajimi mund të jepet disa herë, pra mund të përsëritet.
- Vajimin mund ta japin vetëm Ipeshkvi dhe priftërinjtë



# SAKRAMENTI I VAJIMIT

- Efektet kryesore të këtij Sakramenti janë: ngushëllimi, paqja dhe kurajoja për të përballuar vështirësitë e vetë gjendjes së sëmundjes së rëndë ose të dobësisë së pleqërisë, ripërtëritja dhe përforcimi i besimit në Zotin, mbrotja dhe përforcimi kundër tundimeve të të keqit, sidomos kundër tundimit të shkurajimit dhe të ankthit që përjetohet gjatë sëmundjes e sidomos në prag të vdekjes.
- Kjo mbështetje e Vajimit e çon të sëmurin drejt shërimit të shpirtit dhe nqs është vullneti i Zotit, edhe në shërimin e trupit.
- Vajimi fal mëkatet jo të rënda. Në raste ekstreme, kur nuk është e mundur që të bëhet Rrëfimi, Vajimi mund të falë edhe mëkatet e rënda, me kushtin themelor që i sëmuri që e merr të jetë i penduar.




# SAKRAMENTI I VAJIMIT

- Për hirin e Vajimit, i sëmuri merr forcën dhe dhuratën që të bashkohet në mënyrë më intime me Mundimin e Krishtit. Pra, çdo i sëmurë bëhet kështu bashkëpunëtor me Jezu Krishtin në shëlbimin e botës.
- Nqs i sëmuri ka humbur vetëdijen mund t'i jepet Vajimi, nqs përpara i sëmuri ka shprehur lirisht vullnetin për ta marrë.
- Kisha Katolike përcakton si Sakramente që mbyllin jetën tokësore të çdo njeriu: Sakramentin e Rrëfimit, të Vajimit Ekstrem dhe të Eukaristisë (Kungimit), e cila quhet në këtë rast Viatiku, pra Kungimi i fundit, Kungimi i kalimit nga kjo botë në gjirin e Atit të amshuar.
- Nqs ne pranojmë që të marrim këto tre Sakramente në fund të jetës sonë ato janë për ne çelësat e Shën Pjetrit, janë ato që na shpartallojnë dyet e Parajsës dhe na ndihmojnë që të shkojmë në gjirin e Atit, aty ku na pret Ati, Jezusi, Shpirti i Shenjtë me të gjithë engjëjt e shenjtërit.



*“Njerëzit gënjejnë edhe mbi mjellmat dhe mendojnë se ato, përpara se të vdesin, këndojnë prej dhimbjes. Por asnjë zog tjetër kur ka uri, ftohtë ose ndonjë shqetësim tjetër nuk e shpreh me këngë vuajtjen e vet. Mjellmat, të shenjta për Apollon, në fund të jetës së tyre, duke e parashikuar të mirën që do të gjejnë tek të bashkuarit sërish me zotin e tyre, gëzohen. Në të njëjtën mënyrë, Sokrati, mik i mjellmave dhe jo më pak se ata profet, gëzohet. Ai është i sigurtë se, në momentin që shpirti i tij do të lirohet nga zinxhirët e trupit, do të rishikojë më në fund dritën e vërtetë ”. (Platoni)*





# SAKRAMENTI I MARTESËS



# SAKRAMENTI I MARTESËS

Pakti martesor, me anë të të cilit burri e gruaja vendosin midis tyre bashkëndarjen e jetës së tyre, për natyrën e vet e drejtuar tek e mira e bashkëshortëve dhe tek riprodhimi dhe edukimi i fëmijëve, ndër të pagëzuarit është ngritur nga vetë Krishti Zot në dinjitetin e sakramentit.

Duhet të dallojmë midis martesës "natyrore", siç e ka menduar Hyji që në fillimet e krijimit, kur ka krijuar botën dhe sidomos burrin e gruan, dhe martesës "sakramentale", pra martesës në kishë:

- **Martesa natyrore:** Martesa midis burrit dhe gruas ka qenë në planet e Zotit që në fillimet e krijimit; Vetë Zoti e ka themeluar martesën, sikurse shkruhet në Zanafilla 1, 26-28. Pra, martesa nuk është një institucion njerëzor, por hyjnor. Thirrja për t'u martuar është e shkruar në natyrën e vetë njeriut, e çdo burri dhe çdo gruaje që kanë dalë nga duart e Zotit, Krijuesit tonë.
- Realiteti që ndodh në martesën, realitet që spikat akoma më shumë në martesën sakramentale, por vlen edhe për martesën natyrore, është që gruaja e burri që martohen bëhen një mish i vetëm, një trup i vetëm. Përbiles Jezusi vetë e përsërit këtë gjë, dhe e gjejmë në ungjillin e Mateut 19, 4-5.
- **Martesa sakramentale:** objektivi themelor i saj është t'i bëjë bashkëshortin e bashkëshorten shenjt nëpërmjet këtij "mjeti specifik të hirit", dmth t'i bëjë të lumtur, dhe po ashtu duke qenë sakrament, është një "shenjë e shenjtë", pra një shenjë efikase e një realiteti më të thellë e më të fshehur që është Aleanca ("Martesa") e Jezu Krishtit me Kishën, dmth me secilin prej nesh.
- **Martesa sakramentale** është themeluar nga vetë Jezu Krishti, në darkën e Kanës. E gjejmë në ungjillin sipas Gjonit, 2, 1-11.



# SAKRAMENTI I MARTESËS

- Ministrat e sakramentit të Martesës janë vetë nusja dhe dhëndri, të cilët i japin njëri tjetrit sakramentin, duke shprehur konsensusin (miratimin) reciprok. Pra, nuk është prifti ai që i marton, por ai duhet të jetë i pranishëm, sepse merr pëlqimin e tyre reciprok dhe u jep bekimin. Duhet gjithashtu të jenë të pranishëm edhe dy dëshmitarët e martesës.
- Për të celebruar një sakrament martesë të vlefshëm, duhet që ministrat e këtij sakramenti të jenë një burrë dhe grua (martesë monogamike, midis individëve të seksit mashkull dhe femër), të pagëzuar, në gjendje të lirë dhe të shprehin lirisht konsensusin (miratimin) e tyre.
- Pa konsensus reciprok nuk ka martesë! Konsensusi është një element themelor i martesës, është një akt njerëzor nëpërmjet të cilit ministrat e martesës i jepen njëri tjetrit. Konsensusi duhet të jetë një akt vullnetar, i lirë nga nga çdo lloj dhune apo presioni (fizik, psikologjik) apo detyrimi të jashtëm. Nqs ky element themelor mungon, sakramenti i Martesës nuk është i vlefshëm: kjo do të thotë që nuk është celebruar asnjë lloj martesë, dy individët nuk janë të martuar dhe martesë në këtë rast është "null".
- Tre arsye kryesore për të cilat një martesë është e pavlefshme janë: për difekt në konsensus, kur ka një pengesë vendimtare dhe kur ka difekt substancial në formë.
- Kisha nuk ka të drejtë të anulojë një Sakrament Martesë që është i vlefshëm, kurrë dhe në asnjë rast, por mund të anulojë vetëm ato martesë që zbulohen të kenë qenë të pavlefshme (pra që në fakt nuk është bërë Sakramenti i Martesës). Më saktë, thuhet që Kisha në këto raste "deklaron null" këto Martesë në kishë, ose jep vendimin e nullitetit të martesave.



# SAKRAMENTI I MARTESËS

- Sakramenti i Martesës është jo i ligjshëm kur dy individët martohen në mënyrë të vlefshme, por në mëkat të rëndë. Sakramenti i Martesës, duke qenë një Sakrament i të gjallëve (shpirtërisht), duhet të merret në hir të Zotit, jo në gjendje mëkati të rëndë. Nqs merret në gjendje mëkati të rëndë, bëhet sakrilegj dhe për më tepër, bëhet jo i ligjshëm dhe jo i frytshëm, pra hiri i Zotit specifik që merret nëpërmjet Sakramentit të Martesës në këtë rast nuk i jep frytet e veta, pasi gjen një pengesë të madhe që është mëkati i rëndë.
- Por, nqs individët kthehen sërish në hir të Zotit, hiri i Sakramentit të Martesës "rigjallërohet".



# SAKRAMENTI I MARTESËS

- **Karakteristikat e Sakramentit të Martesës janë:**

1. Monogamia (lidhja martesore midis burrit e gruas është unike dhe ekskluzive)

2. Besnikëria (të martuarit në kishë duhet të jenë bësNIK ndaj njëri tjetrit)

3. Pazgjidhshmëria (Pra, për të martuarit në kishë as nuk mund të flitet për divorc, duke sakramenti i martesës i pazgjidhshëm; nqs bëhet martesa në kishë nuk mund të zgjidhet nga askush, sepse është Hyji që e ka themeluar dhe është Hyji që e ka përcaktuar të tillë martesën. Pazgjidhshmëria e martesës i përket të drejtës hyjnore. E gjejmë në Mateu 19, 3-6).

Kur bashkëshorti/ja tradhTOhet (sidomos kur tradhTOhet në mënyrë të vazhdueshme dhe pa asnjë lloj shenjë pendimi), si edhe në raste të tjera të rënda si psh kur burri luan bixhoz duke shpërdoruar të gjitha paratë e familjes, kur përdor drogë/alkol/ është i dhunshëm etj. atëhere Kisha LEJON që të bëhet ndarja fizike: pra dy bashkëshortët të mos bashkëjetojnë më njeri tjetrin. Kjo gjë lejohet për të ruajtur integritetin e palës së tradhtuar ose të fëmijëve që mund të kenë, ose të gjendjes ekonomike/trashëgimisë së familjes, që përndryshe do vihej në rrezik të rëndë.



# SAKRAMENTI I MARTESËS

Qëllimet e Sakramentit të Martesës janë:

- a. Qëllimi përfundimtar dhe themelor i Sakramentit të Martesës është shenjtërimi i dy bashkëshortëve.
- b. Qëllimet e afërta të martesës janë riprodhimi dhe edukimi i fëmijëve. Aktet seksuale gjatë martesës duhet të jenë të hapura ndaj jetës, dmth bashkëshortët nuk duhet të përdorin kontracepsion.

- Përsa i përket martesës në kishë midis një të pagëzuari katolik dhe një të pagëzuari të një feje tjetër të krishterë (ortodoks, protestant), që quhet martesë mikse, mund të bëhet dhe kjo martesë është e vlefshme. Sidoqoftë, për të qenë të ligjshme, këto martesë kanë nevojë për një liçensë të caktuar nga autoriteti përkatës.
- Përsa i përket martesës në kishë midis një të pagëzuari katolik dhe një jo të pagëzuari (musliman, budist, hindu, i pafe etj), kjo martesë quhet martesë me pabarazi kulti dhe duke qenë se ekziston një pengesë për këtë lloj martesë, kjo martesë në Kishë nuk është e vlefshme.
- Megjithatë, nëpërmjet një autorizimi të caktuar mund të hiqet kjo pengesë dhe bëhet e vlefshme martesë në Kishë midis këtyre dy individëve. Ky autorizim mund të jepet por duhet të plotësohen tre kritere kryesore që janë që pala katolike të mos e braktisë fenë e vet dhe të premtojë që do të bëjë çmos për të edukuar fëmijët në fenë katolike; pala jo e krishterë të jetë e informuar mbi premtimet dhe detyrimet e palës katolike dhe të dyja palët të jenë të informuara mbi karakteristikat e sakramentit të martesës, që nuk duhet të përjashtohen nga asnjëra palë.



# SAKRAMENTI I MARTESËS

- Martesa vetëm në gjendje civile midis dy të pagëzuarve nuk është e vlefshme në Kishë, pra është kanonikisht null. Kjo do të thotë që përpara Zotit, këta dy njerëz janë si të pamartuar e duke qenë në gjendje mëkati të rëndë, nuk mund të marrin sakramentin e rrëfimit dhe të kungimit.
- Gjithsesi, duke qenë martesa e dy të pagëzuarve vetëm në gjendje civile **KANONIKISHT** null (pra null për shkak të një çrregullsie), në momentin që ato e rregullojnë këtë çrregullsi, mund të martohen në kishë. Në këtë rast, për të marrë Sakramentin e Martesës, mund të bëhet ajo që e quajmë *sanatio in radice*, pra që martesa civile midis dy të pagëzuarve katolikë, për ndërhyrjen e Ipeshkvit, bëhet Sakrament i Martesës. Kjo mund të bëhet direkt, (pasi janë përgatitur mirë të dy), edhe pa ritualin tipik fetar në Kishë.
- Për ata çifte që bashkëjetojnë nuk mund të bëhet *sanatio in radice*.



# SAKRAMENTI I MARTESËS

- Nqs një çift të pagëzuarish që ka qenë i martuar vetëm në gjendje civile divorcohen nga njëri tjetri, secili prej tyre mund të marrë Sakramentit e Martesës në kishë me një person tjetër.
- Nqs një njeri është martuar në kishë, ndahet në gjendje civile dhe martohet civilisht me një njeri tjetër, martesë vetëm civile me gruan/burrin tjetër përveçse kanonikisht null, është edhe një tradhti jashtëmartesore e vazhdueshme, kështu që ai/ajo që rimartohet në gjendje civile në asnjë mënyrë nuk mund të marrë pjesë në Sakramentet e Kishës Katolike (Rrëfimi, Kungimi).
- Po ashtu, nqs të rimartuarit në gjendje civile kanë fëmijë midis tyre, sidomos kur janë të vegjël, për të mos e prishur më tej ekuilibrin e familjes së re të krijuar, sidomos të fëmijëve të pafajshëm që kanë nevojë për praninë e dy prindërve, mund të jetojnë së bashku dhe mund të marrin Rrëfimin e Kungimin vetëm nqs jetojnë si vëlla e motër (pra nuk duhet të kenë marrëdhënie seksuale midis tyre) dhe nqs Sakramentet i marrin në një Kishë tjetër larg vendit ku ata jetojnë, për të mos krijuar skandal midis besimtarëve.





# SAKRAMENTI I URDHRIT TË SHENJTË



# SAKRAMENTI I URDHHRIT

- Sakramenti i Urdhrit të Shenjtë është një nga shtatë Sakramentet e Kishës Katolike, falë të cilit misioni që Jezu Krishti u ka dhënë Apostujve të tij vazhdon të ushtrohet në Kishë deri në fundin e kohërave.
- Fjala “urdhër” vjen nga fjala latinisht “ordinatio” pra “urdhërim”, që në antikitetin romak kishte të bënte me futjen në një “ordo” , pra në një urdhër. Urdhërimi “Ordinatio (në lat.)” quhet ndryshe edhe “Consecratio (në lat.)”, që do të thotë “shugurim”, “kushtim”.
- Sakramenti i Urdhrit ka tre gradë: Ipeshkvia, presbiterati (priftëria) dhe diakonati.
- Sakramenti i Urdhrit është themeluar nga vetë Jezu Krishti. Themelet biblike i gjejmë në ungjillin sipas Markut 3, 13-19, në të cilin tregohet për përzgjedhjen e të Dymbëdhjetëve nga vetë Jezusi, të cilët i bën apostuj. Apostujt i thërret dhe i dërgon secilin personalisht; ata marrin pushtetin drejtpërdrejtë nga Jezu Krishti që të predikojnë dhe të dëbojnë djajtë dhe pushtetin e veçantë që të kremtojnë Eukaristinë (Meshën) e Shenjtë (Luka 22, 14-20) dhe që të falin mëkatet (Gjoni 20, 19-24).



# SAKRAMENTI I URDHURIT

- Për të siguruar trashëgiminë e të gjitha thesareve dhe të pushtetit të dhënë nga Jezusi apostujve të përzgjedhur nga vetë ai, ekziston “vazhdimësia apostolike”.
- Këta njerëz të cilëve u transmetohet, nëpërmjet një zinxhiri që nuk shkëputet deri në ditët tona, po i njëjti pushtet që kanë patur 12 apostujt e Jezu Krishtit janë lleshkvit (pasardhësit e Apostujve).
- Transmetimi i këtij pushteti hyjnor, të dhënë nga vetë Jezu Krishti, bëhet duke u lutur dhe duke u vënë duart mbi kandidatin (mbi pasardhësin e apostujve). Themelet biblike i gjejmë në Veprat e Apostujve 13, 1-3, Letra e dytë drejtuar Timoteut 1, 6-11, Letra e parë drejtuar Timoteut 5, 22 dhe Letra drejtuar Titit 1, 5.
- Apostujt kishin caktuar për çdo komunitet ca të moshuar (që në greqisht quhen “presbiteroi”) pra presbiterë ose priftërinj. Kështu, themelohet edhe Urdhri i presbiterëve ose priftërinjve. E gjejmë në Veprat e Apostujve 14, 21-23.
- Urdhri i diakonëve është themeluar me 7 burra që janë bërë diakonët e parë në historinë e katolicizmit. E gjejmë në Veprat e Apostujve, 6, 1-6.



# SAKRAMENTI I URDHHRIT

- Ipeshkvia është grada e parë e Sakramentit të Urdhrit.
- Ipeshkvit janë pasardhësit e Apostujve. Ata marrin plotësinë e Sakramentit të Urdhrit.
- Ipeshkvit nëpërmjet këtij Sakramenti marrin detyrën e trefishtë për të mësuar, për të shenjtëruar (duke u identifikuar me vetë Personin e Krishtit- in Persona Christi Capitis) dhe për të udhëhequr popullin si barinj të mirë.
- Presbiterët (që janë ato që ne i quajmë në gjuhën e përditshme priftërinjtë) janë bashkëpunëtorë të Ipeshkëve në detyrën e tyre të trefishtë. Në mënyrë të veçantë, ato bëjnë rolin e shenjtërimit të njerëzve, që shprehet kryesisht në kultin e celebrimin e Sakramenteve, kulmin e të cilëve e arrijnë në celebrimin e Eukaristisë.
- Presbiterët janë pjesëmarrës me Ipeshkvin në pushtetin e shenjtë që u ka dhënë Jezusi, por nuk e kanë plotësinë e priftërisë. Ata varen nga Ipeshkvi në ushtrimin e pushtetit të tyre dhe duhet t'i binden atij.



# SAKRAMENTI I URDHHRIT

- Diakonati është grada e tretë e Sakramentit të Urdhrit. Atyre u jepet ky Sakrament jo për priftërinë, por për shërbimin. Pra, ata nuk janë priftërinj dhe nuk mund të administrojnë disa Sakramente.
- Diakonët mund të japin Pagëzimin, të ndihmojnë Ipeshkvin dhe priftërinjtë gjatë kremtimit të Meshës, t'u japin Kungimin njerëzve, të jenë pjesëmarrës dhe të japin bekimin gjatë Sakramentit të Martesës, të shpallin Ungjillin (pra ta lexojnë Ungjillin gjatë Meshës), të bëjnë homelinë dhe të predikojnë, të kryesojnë funeralet (kur funeralet bëhen pa Meshë të shenjtë si psh. kur mungon prifti për të bërë liturgjinë Eukaristike, bëhet vetëm liturgjia e Fjalës) dhe sidomos të merren me shërbime të ndryshme që kanë të bëjë me ndihmën.
- Diakonët marrin një karakter, një "vulë" shpirtërore që nuk mund të fshihet kurrë, që e konformon (e bën të ngjashëm) diakonin me Krishtin shërbëtor.
  
- Diakonët e përhershëm mund të jenë të pamartuar ose të martuar:
- Nqs ata e marrin diakonatin të pamartuar, rrinë përgjithmonë të tillë, pra nuk martohen.
- Nqs e marrin diakonatin kur janë të martuar, mund të bëhen diakonë të përhershëm dhe normalisht të vazhdojnë martesën e tyre.
- Nqs këtyre të fundit, pasi janë bërë diakonë, u vdes gruaja, nuk mund të rimartohen.



# SAKRAMENTI I URDHHRIT

- Sakramenti i Urdhrit është një vulë shpirtërore. Ai nuk mund të përsëritet, as të eliminohet. Mbetet përgjithmonë në shpirtin e njeriut.
- Nëpërmjet Pagëzimit, çdo i krishterë bëhet mbret, prift e profet. Por, priftëria e çdo të pagëzuari ndryshon nga priftëria e dy gradëve të para të Sakramentit të Urdhrit, sepse e konformon (e bën të ngjashëm, e përshtat) atë që e merr me Krishtin Kokë (Koka e Kishës) dhe Bari i mirë.
- Ai që bëhet prift duke marrë dy gradët e Sakramentit të Urdhrit vepron (në disa raste) in persona Christi, pra duke u identifikuar në personin e Krishtit.



# SAKRAMENTI I URDHHRIT

- Sakramentin e Urdhrit mund ta marrë vetëm individi i pagëzuar i seksit mashkull. Kjo për arsye të traditës (Kisha ka qenë gjithnjë dakord dhe ka urdhëruar gjithnjë vetëm meshkuj), të sjelljes së Jezusit (ai ka urdhëruar vetëm meshkuj, por jo për shkak të konformimit me mentalitetin e aso kohe sepse ai nuk ka patur asnjë paragjykim kundrejt femrave); të zakonit të Apostujve (që kanë vepruar po ashtu si Jezusi).
- Duke qenë se urdhërimi i priftërinjve vetëm meshkuj është një e drejtë hyjnore, ndryshe nga të drejtat ekleziastike gjërat që i përkasin të drejtave hyjnore, janë të përcaktuara nga vetë Hyji dhe nuk mund t'i prekë asnjë njeri, as njerëzit e klerit, as vetë Ati i shenjtë. Pra, **KURRË E ASNJËHERË KISHA KATOLIKE NUK DO T'UA JAPË SAKRAMENTIN E URDHHRIT FEMRAVE!**
- Duke qenë se çështja tjetër (a mund të urdhërohen priftërinj të martuar apo jo) i përket së drejtës ekleziastike, do të thotë që kjo nuk është përcaktuar nga vetë Jezu Krishti, nga Hyji, por nga Kisha dhe si e tillë, mund të ndryshojë në kohë nga vetë Kisha pasi ajo e ka përcaktuar dhe ka të drejtë ta ndryshojë si e kur të dojë,
- Në Kishat Katolike të ritit latin ata meshkuj që marrin Sakramentin e Urdhrit të Shenjtë janë të pamartuar (beqarë) dhe nuk mund të martohen.
- Kurse, në Kishat Katolike të ritit grek mund të marrin Sakramentin e Urdhrit edhe meshkuj të martuar.

# SAKRAMENTI I URDHHRIT

- Duke qenë se Kisha Katolike e ritit latin nuk pranon që një prift i shuguruar që e ushtron ministerin e tij të martohet (pra o duhet të bëjë njërën, o tjetrën) atëhere Kisha Katolike bën për këto priftërinj që martohen "reduktimin në gjendjen laikale", çka do të thotë që edhe pse në ata mbetet Sakramenti i Urdhrit që nuk mund të fshihet kurrë, nuk mund ta ushtrojnë më pushtetin e tyre hyjnor apostolik, dmth nuk mund as të kremtojnë Meshën, as të rrëfejnë njerëzit.
- Prifti vazhdon veprën e shëlbimit mbi tokë. Nqs do ta kuptonim mirë priftin në këtë tokë, nuk do të vdisnim nga frika, por nga dashuria. Priftëria është dashuria e zemrës së Jezusit". (Shenjti Kurato i Arsit, pajtori i priftërinjve)



Faleminderit!

Për më tepër vizitoni  
sitin:

[www.beatoalano.it/al](http://www.beatoalano.it/al)

